



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008, të nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b**, nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2021, miratoi këtë

**VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË PAKOS  
EKONOMIKE EMERGJENTE**

- I. MIRATOHET Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Pakos ekonomike emergjente, nr. 01-400/04-64478/20, dt. 14.04.2020.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, ndryshohet pika 6 e Vendimit, ku lirimi nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirës publike nga bizneset (sezoni verë dhe dimër) bëhet edhe për vitin 2021.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante me të.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-400/04-185440/21, më 03.09.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Agim Kuleta**

